

Possibilities of Democracy



**NATIONAL
DEMOCRATIC
INSTITUTE**

FOR INTERNATIONAL AFFAIRS



The National Democratic Institute of International Affairs (NDI) first began programs in Albania in 1991. Since early 2000, NDI has concentrated its efforts in two programs, Civic Forum and the Political Party Development program (known as ZHUP). Through these programs, NDI has worked with more than 5000 citizens and hundreds of politicians to generate a better understanding of democratic principles and practices. Supported by the U.S. Agency for International Development (USAID), and working in cooperation with international and Albanian partners—including NGOs, local governments, journalists, and individual politicians—NDI designed and delivered programs that were relevant, timely, and set roots for lasting change.

In the summer of 2004, NDI staff returned to some of the communities and individuals with whom we had the pleasure of working. Some of these people are "ordinary citizens" who learned that active participation in local decision-making is both a right and a responsibility. Others are political activists, reform minded and highly motivated individuals with a vision of party politics that is robust, transparent, and responsive.

We have the pleasure of sharing just a few of their stories. As you read, you might be struck by how common each person seems to be. But that is the point. With just a little guidance and information, real changes in people's mentality and in their ability and willingness to take action occur. In short, these citizens, these young politicians show us clearly the possibilities of democracy.

We hope you are as inspired as we at NDI are in their stories.

Jennifer L. Butz
Country Director, NDI/Albania
Program Director, Civic Forum
August 2004 Tirana, Albania



Instituti Kombëtar Demokratik për Punët e Jashtme (NDI) në Shqipëri, fillimisht, ka nisur punën e tij këtu në vitin 1991. Që në fillim të vitit 2000, NDI ka përqendruar përpjekjet e tij në dy programe, Forumi Civil dhe Zhvillimi i Partive Politike (i njohur si ZHUP). Përmes këtyre programeve, NDI ka punuar me më shumë se 5000 qytetarë dhe qindra politikanë për të gjeneruar një kuptim më të mirë të parimeve dhe praktikave demokratike. I mbështetur nga Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), dhe në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtar dhe Shqiptar - përfshirë këtu, OJQ, Pushtetin Vendor, gazetarë, dhe politikanë - NDI ka hartuar dhe shpërndarë programe që kanë qenë përkatës, në kohën e duhur dhe që kanë hedhur rrënjët për një ndryshim të qëndrueshëm.

Në verën e vitit 2004, NDI u rikthye tek disa komunitete dhe individë me të cilët kemi patur kënaqësinë të punojmë. Disa prej këtyre njerëzve janë "qytetarë të thjeshtë" që kanë mësuar se pjesëmarrja aktive në vendimmarrjen vendore është jo vetëm një e drejtë por dhe përgjegjësi e tyre. Të tjerët janë aktivistë politik, individë me mendësi të reformuar dhe tejet të motivuar, me vizion për një politikë partiake që është e shëndoshë, transparente, dhe e ndjeshme.

Ne kemi kënaqësinë të ndajmë me ju vetëm disa prej historive të tyre. Ndërsa lexoni, mund të befasoheni kur të kuptoni se sa të thjeshtë janë këta njerëz. Por këtu qëndron dhe thelbi. Me vetëm pak udhëzim dhe informacion, shfaqen ndryshimet e vërteta në mendësinë e njerëzve, në aftësitë dhe gatishmërinë e tyre për të ndërmarrë veprime. Shkurt, këta qytetarë, këta politikanë të rinj na tregojnë qartazi mundësitë e demokracisë.

Shpresojmë që ju të jeni po aq të frymëzuar nga historitë e tyre sa edhe ne këtu në NDI.

Jennifer L. Butz
Drejtoreshë Vendore, NDI/Shqipëri
Drejtoreshë e Programit, Forumi Civil
Gusht 2004 Tiranë, Shqipëri

"Throughout history...

It has been the inaction of those who could have acted;
The indifference of those who should have known better;
The silence of the voice of justice when it mattered most;
That has made it possible for evil to triumph."

Haile Salasie

"Përgjatë gjithë historisë...

Ka qenë mosveprimi i atyre që mund të kishin vepruar;
Indiferenca e atyre që duhet të dinin më shumë;
Heshtja e zërit të drejtësisë kur nevojitesh më shumë;
Që ka bërë të mundur triumfin e të keqes."

Haile Salasie

1. Etleva Bisha, *(LSI) Tiranë City. Political party program*
2. Qemal Cara, *Shënavlash, Durrës. Civic Forum*
3. Enver Çaushti, *Pezë, Tiranë. Civic Forum*
4. Enkelejda Çela, *Tiranë City. Civic Forum*
5. Reshit Dedej, *Lekaj, Kavajë. Civic Forum*
6. Mimoza Hasekiu, *(PD) Elbansan. Political party program*
7. Alma Lahe, *(HRUP) Tiranë City. Political party program*
8. Elton Lika, *Farkë e Madhe, Tiranë. Civic Forum*
9. Ndue Marku, *Shkozet, Durrës, Civic Forum*
10. Sandër Marku, *(PD) Lezhë City. Political party program*
11. Elvis Mataj, *(LSI) Tiranë City. Political party program*
12. Rauf Merko, *Sauk, Tiranë. Civic Forum*
13. Haxhi Muka, *Kamëz, Tiranë. Civic Forum*
14. Reis Mulita, *(PSD) Tiranë City. Political party program*
15. Flamur Noka, *(PD) Tiranë City. Political party program*
16. Hafsa Shehu, *Mullet, Tiranë. Civic Forum*
17. Atlie Xuna, *Synej, Kavajë. Civic Forum*
18. Lavdie Zhuri, *Sineballaj, Kavajë. Civic Forum*

Etleva Bisha Socialist Party



Etleva Bisha has been an active member of the Socialist Party since 1993, holding a variety of posts over the past eleven years. She was the Deputy Chair of the Party's Youth Forum and a member of its National Steering Committee, Chief of Cabinet in the Defence Ministry, and member of the central election campaign team. At the moment, she is the Assistant to Musa Ulqini MP and a local councillor for the municipality of Tirana - a post she first won in 2000.

Etleva joined NDI's Political Parties Development Program in 1998 and says that, "the best thing at NDI was the spirit of cooperation among the members of different parties."

In the 2000 local elections, Etleva was proposed as a local councillor for her party and also served as the campaign manager. She says that it was very easy for her to manage such a campaign after learning more about what makes a good manager in NDI training courses. "It taught me how to get the most from my team," she says.

She organized a 'door-to-door' canvassing, designed very colorful and effective leaflets and posters and also led the media campaign. Not surprisingly, her winning efforts were widely considered the most successful campaign in Tirana.

Even after Etleva started work as local councillor, she kept applying the skills learned from NDI. She says that, "I am preparing a set of election campaign materials for aspiring candidates of all political parties."

Etleva believes that NDI's promotion of the political concept of "one member - one vote" has been very important, as it was an unknown principle in Albanian politics until recently. "The fact that many political forces are seeking NDI's assistance to apply this principle is a significant indicator of NDI's successful and progressive work in Albania." She adds that, "in the future I know that I am going to be part of a party that has internal party democracy and makes room for the individual values of all party members."

For the moment at least, Etleva keeps carrying out her duties as municipal and regional councillor. She also found time to establish the Institute for Public Relations, which aims at creating more transparent and democratic institutions for the public.

"Gjëja më e mirë ishte fryma e bashkëpunimit që krijojë mes anëtarëve të partive të ndryshme politike."

Etleva Bisha ka qenë një anëtare aktive e Partisë Socialiste që prej vitit 1993, duke mbajtur një sërë postesh në 11 vjet. Ajo ka qenë Nën Kryetare e Forumit Rinor Euro-Socialist dhe anëtare e Kryesisë së Përgjithshme të tij, Shefe e Kabinetit në Ministrinë e Mbrojtjes dhe anëtare e shtabit qendror zgjedhor. Aktualisht, ajo është Asistente e Deputetit Musa Ulqini dhe anëtare e këshillit bashkiak të Tiranës - post të cilin e fitoi për herë të parë në vitin 2000.

Etleva u aktivizua në Programin e NDI-së për Zhvillimin e Partive Politike në vitin 1998 dhe thotë se, "Gjëja më e mirë, tek NDI, ishte fryma e bashkëpunimit që krijojë mes anëtarëve të partive të ndryshme politike."

Në zgjedhjet vendore të vitit 2000 Etleva u propozua si Këshilltare Vendore dhe në të njëjtën kohë ajo kishte dhe rolin e menaxherit të kësaj fushate. Ajo përmend se e kishte shumë të lehtë të drejtonte një fushatë të tillë pasi mësoi më shumë se si të jesh një menaxher i mirë në kurset e NDI. "NDI më mësoi se si të merrja maksimumin prej skuadrës time," thotë ajo.

Ajo organizoi një fushatë derë më derë, hartoi fletë-palosjet dhe posterat si dhe ishte në krye të fushatës publicitare në media. Prandaj, jo rastësisht, përpjekjet e saj fituese u konsideruan gjerësisht si më të suksesshmet në Tiranë.

Por edhe pasi filloi të punonte si këshilltare vendore ajo vazhdoi të zbatonte leksionet e marra tek NDI. Ajo thotë se, "kam filluar përgatitjen e një pakete materialesh për kandidatët aspirant në të gjitha partive politike."

Etleva beson se prezantimi nga ana e NDI të konceptit politik "një anëtar një votë" - ka qenë shumë i rëndësishëm duke pasur parasysh se ky koncept ka qenë i panjohur në politikën Shqiptare deri së voni. "Fakti që disa forca politike, kanë filluar të kërkojnë asistencën e NDI, për ta zbatuar atë, tregon më së miri se sa e suksesshme dhe progresiste është puna e NDI-së në Shqipëri." Ajo shton se, "Edhe unë vetë në të ardhmen di që do të jem anëtare e një partie që ka demokraci të brendshme dhe ka hapësirat e nevojshme për vlerat e të gjithë anëtarëve të partisë."

Për momentin Etleva vazhdon të kryejë detyrën e saj si anëtare e këshillit bashkiak dhe atij të qarkut në Tiranë. Dhe gjithashtu, ka gjetur kohën të krijojë Institutin e Marrëdhënieve me Publikun, i cili synon të zhvillojë institucione më transparente dhe demokratike për publikun.

Manaxhimi e suksesit

Qemal Cara Shënavlash



When citizens started recommending Civic Forum to others, new groups and new ideas began to be shared. A few years ago, an active citizen in Shkallnur, Durrës told us, "Go to Shënavlash, meet with my brother, Qemal Cara, he will help you work with a group of citizens there." Qemal, a tall man with a warm smile, is a long-time police officer and has a strong reputation in the community.

For more than a year Civic Forum worked with Qemal and his neighbors, introducing principles of democracy and offering simple, effective ways to plan and take community action. The goal was to help them understand that democracy is the citizens' system. On the days that the men and women of the upper quarter of Shënavlash met with Civic Forum, they would wake up earlier than usual to finish their morning chores in order to be ready for the 10:00 meeting in Qemal's courtyard.

When field coordinators first introduced the Civic Forum program to him, he asked us, "What will we get from these discussions?" Now, more than two years after he asked us, we returned to Shënavlash to ask him the same question.

"We understood by Civic Forum that voting is worth more than just a simple favor you do for an acquaintance or friend when he shows up and asks for it." Qemal and his neighbours learned that the Constitution provided them the right to participate in the local council meetings.

What sounded incredible two years ago is now common. The citizens in Shënavlash participate in the local council meetings and meet with the mayor and other commune officials to discuss local issues, such as water supply and garbage removal. These meetings with the elected officials resulted in running water for their homes and trucks being sent by the commune to pick up the garbage every other day, but this is not the end of the problem.

Qemal notes that the community actions become stronger when there are more people involved. Bringing more people around the community issues is his next challenge. "Elections are soon. We have lost enough time. If we have really chosen the path of change, let's get to work."

"Nga Forumi Civil ne kuptuam se vota është më shumë se sa thjesht një favor që i bën një të njohuri apo miku kur ai vjen dhe ta kërkon atë."

Kur qytetarët filluan ti rekomandonin Forumin Civil të tjerëve, grupe të reja dhe ide të reja filluan të shkëmbeheshin. Ca vjet më parë, një qytetar aktiv i Shkallnurit, Durrës, na tha, "Shkoni në Shënavlash, takoni vëllain tim, Qemal Carën, ai do t'ju ndihmojë të punoni me një grup qytetarësh atje." Qemali, një burrë i gjatë dhe buzëqeshje të ngrohtë, ka kohë që është në forcën e policisë dhe gëzon reputacion të fuqishëm në komunitet.

Për më shumë se një vit Forumi Civil punoi me Qemalin dhe fqinjët e tij, duke i prezantuar parimet e demokracisë dhe duke i ofruar mënyra të thjeshta dhe të efektshme për të ndërmarrë veprim të komunitetit. Për t'i ndihmuar që të kuptonin se demokracia është një sistem i qytetarëve. Ato ditë që gratë dhe burrat e lagjes së sipërme të Shënavlshit u takuan me Forumin Civil, ata u zgjuan më herët se zakonisht mbaruan punët e përditshme që të ishin gati për takimin e orës 10:00 në oborrin e Qemalit.

Fillimisht, kur koordinatorët e terrenit i prezantuan atij programin e Forumit Civil, ai na pyeti, "Cfarë dote marrim nga këto diskutime?" Tani, më shumë se dy vjet që kur ai na pyeti, ne u kthyem në Shënavlash për ti bërë të njëjtën pyetje.

"Nga Forumi Civil ne kuptuam se vota është më shumë se sa thjesht një favor që i bën një të njohuri apo miku kur ai vjen dhe ta kërkon atë. "Qemali dhe fqinjët e tij mësuan se Kushtetuta i jepte atyre të drejtën që të merrnin pjesë në mbledhjet e këshillit vendor.

Çfarë tingëllonte si e pabesueshme dy vjet më parë tashmë është më se e zakonitë. Qytetarët në Shënavlash marrin pjesë në mbledhjet e këshillave vendor, takohen me kryetarin dhe zyrtarë të tjerë të komunës për të diskutuar çështje si uji apo heqja e plehrave. Këto takime me zyrtarët e zgjedhur sollën si rezultat ujin e pijshëm në shtëpitë e tyre dhe dërgimin e makinave nga komuna për të hequr pehrat ditën tjetër, por kjo nuk do të thotë që problemi mbaron këtu.

Qemali vëren se veprimet e komunitetit bëhen më të fuqishme kur në to bashkohen më shumë njerëz. Përfshirja e më shumë njerëzve në çështjet e komunitetit është sfida e tij e rradhës. "Zgjedhjet po afrojnë. Boll kohë kemi humbur. Nëse vërtet kemi zgjedhur rrugën e ndryshimit, atëherë ti futemi punës."

Zgjedhim rrugën e ndryshimit

Enver Çaushi

Peza



Enver Çaushi works in Pezë e Madhe. He is among the first group of citizens that took part in a Civic Forum discussion group in 2001. One can still find Enver and his friends discussing or taking action together. He is not the same person he was before. As Enver says, "Those seemingly simple conversations transformed us. At the beginning we wondered at many things. We always kept talking with each other after you left from the meetings."

Civic Forum helped Enver understand that citizen participation is indispensable to democracy. Thus, he and his friends joined forces to resolve community issues, including fencing off the sports field, restoring the commune building, cleaning the irrigation canals, etc. Enver and his neighbors made use of the tools and techniques learned during their cooperation with Civic Forum, including activating other citizens and establishing a new kind of relationship with the local government.

Enver has helped start many other new Civic Forum groups in Peza commune. He considers this an obligation of one who knows the value of participating in such a group. "We have created many new discussion groups, but what I would really like is for all Albanians to organize such groups. Everyone should pass through the school of NDI," he says.

Enver also sees utility in educating local officials about democracy. "NDI should think about opening a program for officials, especially the local officials, regarding transparency. This would facilitate the citizen-official communication and also establish a positive climate for cooperation." He considers improving one's knowledge of democracy and citizen organization as an ongoing process. Therefore, he keeps devouring any materials on democracy.

Even though Enver's Civic Forum days are over, his participation goes on. "We are still a group with Xhepi, Gonia, Shqipja and others. But there is a difference, now, between the past and the present, regarding the contacts we have with local government. Back then we contacted them but didn't know the law. Now when we contact local officials it is to present requests based on law or take part in the local council meetings."

Enver Çaushi, known and respected by everyone in the commune of Peza, is a simple citizen. But his commitment to the community, his ability to draw people's attention to shared issues, and to organize actions that address those issues all help to improve life throughout Peza.

Democracy looks different

"Ne kemi krijuar shumë grupe të tjera diskutimi, por ajo që dëshirojë është që të gjithë shqiptarët të organizonin grupe të tilla."

Enver Çausi punon në Pezën e Madhe. Ai është një nga të parët e grupit të qytetarëve që morën pjesë në grupin e diskutimit të Forumit Civil në vitin 2001. Megjithatë, ende Enverin mund t'a shohësh duke diskutuar dhe duke marrë veprime të përbashkëta me shokët e tij, ai nuk është më ai i pari. "Ato që dukeshin si biseda të thjeshta na transformuan. Në fillim ne rrinim dhe mendonim për shumë gjëra. Gjithmonë, vazhdonim të flisnim me njëri-tjetrin edhe pasi ju largoheshit prej takimit."

Forumi Civil e ndihmoi Enverin të kuptonte se pjesëmarrja qytetare ishte e domosdoshme për demokracinë. Kështu që, ai dhe shokët e tij bashkuan forcat për të zgjidhur çështjet e komunitetit duke përfshirë rrethimin e fushës sportive, restaurimin e ndërtesës së administratës së komunës, pastrimin e kanaleve ujitës, etj. Enveri dhe fqinjët përdorën mjetet dhe teknikat që mësuuan gjatë bashkëpunimit të tyre me Forumin Civil, përfshirë këtu, aktivizimin e qytetarëve të tjerë dhe krijimin e një marrëdhënie të re me pushtetin vendor.

Enveri ka ndihmuar në krijimin e grupeve të tjerë të Forumit Civil në komunën e Pezës. Ai e konsideron këtë fakt si një detyrim të kujtudo që ia di vlerën pjesëmarrjes në një grup të tillë. "Çdokush duhet ta kalojë shkollën e NDI-së," thotë ai.

Enveri shikon si të dobishëm edhe edukimin e zyrtarëve vendorë për demokracinë. "NDI duhet të mendojë për të hapur një program për zyrtarët, sidomos, për zyrtarët vendorë, në lidhje me transparencën. Kjo do të lehtësonte komunikimin qytetarë-zyrtarë dhe do të krijonte një klimë pozitive për bashkëpunim." Ai e konsideron përmirësimin e njohurive të demokracisë dhe të organizimit të qytetarëve si një proces të vazhdueshëm. Prandaj, ai nuk lë ti shpëtojë asnjë material për demokracinë.

Edhe pse ditët e tij me Forumin Civil kanë mbaruar, pjesëmarrja e tij vazhdon. "Ne, ende, jemi një grup me Xhepin, Gonen, Shqipen dhe të tjerët. Por, tani, ka një ndryshim mes të shkuarës dhe të tashmes, sa i përket kontakteve që ne kemi me pushtetin vendor. Më parë, ne kontaktonim me ta por nuk e njihnim ligjin. Kurse, tani, ne kontaktojmë me zyrtarët vendorë për të paraqitur kërkesa të bazuara në ligj ose për të marrë pjesë në mbledhjet e këshillit.

Enver Çausi, i njohur dhe i respektuar nga cilido në komunën e Pezës, është një qytetar i thjeshtë. Por angazhimi i tij ndaj komunitetit, dhe aftësia e tij për të tërhequr vëmendjen e gjithësecilit për çështjet e përbashkëta dhe për organizimin e veprimeve për ti adresuar këto çështje ndihmojnë në përmirësimin e jetës në mbarë Pezën.

Demokracia duket ndryshe

Enkelejda Çela Tirana



Enkelejda Çela has been an active participant in Albania's political culture for a number of years, but it wasn't until she started participating in Civic Forum discussions that she finally appreciated the full and powerful role of "citizen." Enkelejda works at Albtelecom in Tirana. She is the former chair of the Human Rights Party Women's Forum and was even a candidate during the 2001 parliamentary elections.

Recently, she used skills learned through Civic Forum to organize her neighbors and improve their piece of Tirana, demonstrating the meaning of an engaged citizen. "I appreciate the opportunity Civic Forum gave us to get to know some techniques of community organizing," she says. Enkelejda was concerned about the growing number of illegal buildings that were filling the spaces between residential buildings - places where children used to play and where neighbors would walk in the evenings.

Enkelejda set up an Allies Citizen group, which chose a petition drive as its strategy. The group named the petition "freeing the green areas and public territories," and going door-to-door they encouraged their neighbors to understand that the situation did not have to become worse. "In the beginning it was not easy. There were doors that didn't open. On the other hand, there were citizens who embraced the cause right away and came to our support."

The group then selected two people to represent it when the petition was delivered to the local government. The local council agreed that the buildings represented a violation of laws and procedures and had them torn down and the debris removed. "The triangle of people-power-action is really effective," says Enkelejda. "This was a great success for the citizens."

Recently, Enkelejda learned that a friend of hers, Zaira, is facing a similar challenge in her neighborhood. Enkelejda is helping Zaira organize her own petition. Enkelejda knows that the most important thing is having the will to start change.

Freeing the green zones

"Në fillim nuk ishte e lehtë. Kishte dyer që nuk hapeshin. Por nga ana tjetër, kishte qytetarë që rrokën çështjen tonë."

Enkelejda Çela ka qenë pjesëmarrëse aktive në kulturën politike të Shqipërisë për vite me rradhë, por vetëm kur filloi të merrte pjesë në diskutimet e Forumit Civil ajo më së fundi vlerësoi rolin e plotë dhe të fuqishëm të "qytetarit." Enkelekjda punon tek Albtelecom në Tiranë. Ajo ka qenë kryetare e Forumit të Gruas në Partinë e Bashkimit të të Drejtave të Njeriut, madje dhe kandidatë gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2001.

Së fundi, ajo ka përdorur aftësitë e marra në Forumin Civil për të organizuar fqinjët e saj në mënyrë që të përmirësojnë atë copëz të tyren të Tiranës, duke demonstruar domethënien e një qytetari të angazhuar. "Unë vlerësoj mundësinë që na dha Forumi Civil për të njohur disa njohuri të organizimit të komunitetit," thotë ajo. Enkelejda ishte e shqetësuar për numrin në rritje të ndërtesave ilegale që po mbushnin hapësirat midis pallateve - vende ku luanin fëmijët dhe ku fqinjët shëtisnin mbrëmjeve.

Enkelejda ngriti grupin e Qytetarëve Aleatë, i cili zgjodhi peticionin si strategji të tijën. Grupi e quajti këtë peticion, "çlirimi i hapësirave të gjelbërta dhe ambjenteve të përbashkëta," dhe duke shkuar derë më derë ata i nxitën fqinjët që të kuptonin se gjendja nuk duhet të bëhej më keq se ç'ishte. "Në fillim nuk ishte e lehtë. Kishte dyer që nuk hapeshin. Por nga ana tjetër, kishte qytetarë që rrokën çështjen tonë njëherazi dhe na mbështetën deri në fund."

Më pas, grupi përzgjodhi dy vetë për ta përfaqësuar atë kur peticioni u dorëzua në pushtetin vendor. Mini-bashkia pranoi se ndërtesat përbënin shkelje të ligjit dhe procedurave kështu që i shembi ato dhe hoqi gërmadhat. "Trekëndëshi njerëz-fuqi-veprim është vërtetë i efektshëm," thotë Enkelejda. "Ky ishte një sukses i madh për qytetarët."

Së voni, Enkelejda mësoi se një mikja e saj, Zaira, po hasë një sfidë të ngjashme në lagjen e saj. Enkelejda po e ndihmon Zairën për të organizuar peticionin e saj. Enkelejda di që gjëja më e rëndësishme është që të kesh dëshirën për të nisur ndryshimin.

Çlirimi i hapësirave të gjelbërta

Reshit Dedej Lekaj



Reshit Dedej, a teacher in Lekaj's elementary school, was one of the first people to welcome Civic Forum to his community. He found the discussions on democratic principles and action so interesting, he decided that others in his community would benefit from them. Going door-to-door, speaking with neighbors, friends and acquaintances about the importance of citizen participation, he helped create two more discussion groups. "These discussions taught us that democracy is choosing, monitoring the vote, and co-governance," he says.

In July 2003, Reshit and his activist colleagues decided to narrow the gap between the citizens and the elected officials in Lekaj. They administered a simple survey, analyzed the results, and created a community platform of local perspectives and priorities to offer political leaders. Reshit used his good communication skills during meetings with citizens and political leaders, soliciting citizens' opinions and offering them to political party representatives. Reshit and the other community activists convened and facilitated a public discussion for the 2003 local elections between two candidates - one from the right and one from the left. For the first time in Lekaj's democratic history, 40 citizens and political candidates discussed community development alternatives.

"Change is a process, each step taken must be followed by others if we are to move forward. This is one of the most valuable lessons I received during my experience with Civic Forum," stresses Reshit.

In June 2004, the citizens invited the now-mayor (and former SP candidate) to a town hall meeting to hold him accountable for his campaign promises. Working in a newly-formed network that included members from several Civic Forum discussion groups, the citizens planned this meeting in detail, preparing questions, sending out invitations, organizing the venue and, finally, facilitating a session between the mayor and 60 citizens.

Now, Reshit and the members of the Lekaj network are working to define the community priorities for inclusion in the 2005 budget. Once again the citizens are administering surveys to channel their voice to local authorities through participation in local council meetings.

It is this sequence of actions and the efforts of unofficial leaders like Reshit that keep the civic spirit alive in Lekaj. Reshit is not alone in this mission of good citizenship. He has been sharing information and responsibility with other citizens in Lekaj for several years now, multiplying the image and values of the community leader to those citizens that are already gaining power.

The teacher who believes

"Ndryshimi është një proces, çdo hap i hedhur duhet pasuar nga të tjerë nëse duam të ecim përpara.

Reshit Dedej, mësues në shkollën fillore të Lekajt, ishte një nga të parët persona që mirëpriti Forumin Civil në komunitetin e tij. Ai jo vetëm që tregoi interes për diskutimet e zhvilluara mbi parimet dhe veprimet demokratike por gjithashtu vendosi se edhe të tjerë në komunitet do të përfitonin prej angazhimit me Forumin Civil. Duke shkuar derë më derë për të biseduar me fqinjët, miqtë dhe të njohurit për rëndësinë e pjesëmarrjes qytetare, ai ndihmoi në krijimin e dy grupeve të tjera të diskutimit. "Këto diskutime na mësuën se demokracia është të zgjedhësh, të monitorosh dhe të bashkëqeverisësh," ai thotë.

Në Korrik 2003, Reshiti dhe kolegë aktivistë vendosën të ngushtonin hendekun mes qytetarëve dhe zyrtarëve të zgjedhur në Lekaj. Ata administruan një pyetësor të thjeshtë, analizuan rezultatet, dhe krijuan një platformë të komunitetit për perspektivat dhe prioritetet vendore për t'ia ofruar udhëheqësve politikë. Reshiti përdori aftësi të mira komunikimi gjatë takimeve me qytetarë dhe udhëheqës politikë, duke kërkuar opinionin e qytetarëve dhe duke ia ofruar atë përfaqësuesve të partive politike. Reshiti dhe të tjerë aktivistë të komunitetit u mbledhën dhe lehtësuan një diskutim publik për zgjedhjet vendore të vitit 2003 midis dy kandidatëve - një i djathtë dhe një i majtë. Për here në historinë demokratike të Lekajt, 40 qytetarë dhe kandidatë politikë diskutuan alternativat e zhvillimit të komunitetit.

Në Korrik të 2004-ës, qytetarët ftuan kryetarin e tashëm të komunës (ish kandidatin socialist) në një takim të komunës për ti kërkuar atij llogari për premtimet që bëri gjatë fushatës. Duke punuar në një rrjet të sapoformuar qytetarësh i cili përfshin anëtarë nga grupe të ndryshme diskutimi të Forumit Civil, qytetarët planifikuan këtë takim deri në detaje, duke përgatitur pyetjet, duke dërguar ftesat, duke organizuar vendtakimin dhe përfundimisht, duke lehtësuar një séance ndërmjet kryetarit të komunës dhe 60 qytetarëve.

Tani, Reshiti dhe anëtarët e tjerë të rrjetit të Lekajt po punojnë për të përcaktuar prioritetet e komunitetit në mënyrë që ti përfshijnë ato në buxhetin e 2005-ës. Sërish, qytetarët po administrojnë pyetësorë për ta çuar zërin e tyre tek autoritetet vendore përmes pjesëmarrjes në mbledhjet e këshillit vendor.

Është pikërisht njëpasnjëshmëria e veprimeve dhe përpjekjeve të udhëheqësve jo-zyrtarë si Reshiti që mbajnë gjallë frymën e qytetarisë në Lekaj. Reshiti nuk është i vetëm në këtë mision qytetarie. Ai ka shkëmbyer informacion dhe përgjegjësi me qytetarë të tjerë në Lekaj këto vitet e fundit, duke shumëfishuar imazhin dhe vlerat e liderit të komunitetit tek ata qytetarë që sakaq janë duke marrë fuqi.

Mësuesi që beson

Mimoza Hasekiu Democratic Party



By the time Mimoza Hasekiu enrolled in NDI's Political Management Program in 2003, she was already an active elected politician of Elbasan's DP Branch. She has been Chair of Elbasan's Municipal Council from 1996 to 2000 and is now the General Secretary of DP Branch, a member of the Municipal and Regional Council of Elbasan.

Mimoza's success includes managing the Elbasan mayoral campaign in 2003. This makes her one of the very few examples of women undertaking such roles. She controlled all steps of the campaign, and says, "NDI told me that politics is not a hobby but a profession." Viewed from different angles these elections represent a really good model.

First, the selection of the candidate for mayor was made among the civil society and this decision received the agreement of the entire of membership from the steering committees down to the ordinary party member. The same approach was followed even for the commune mayoral candidates.

Second, Mimoza trained the candidates on campaign organization and on public presentation skills. "During these trainings I made use of all those progressive ideas and visions received from NDI, starting from the door-to-door campaign, in order to be closer to voters and to develop a strong message."

Third, Mimoza and her staff leveraged limited financial resources with intensive use of human resources. Indeed, the campaign she ran had fewer funds compared to her opponents. The DP won eight major communes and the municipality, ousting the two-term Socialist incumbent.

Mimoza is working now to encourage greater women's participation in politics and promoting tolerance and respect for different views within her party. She is also committed to improving the professional capacities among politicians and political authorities. "The local government should be well-managed in order to get to the central government," she said.

If Mimoza makes as much progress in these goals as she has been making in her political life so far, there can be no doubt that many will benefit from her devotion and energy.

The professional politician

"Mua si Zhupiste NDI-ja më tregoi se politika nuk është hobi por profesion."

Kur Mimoza Hasekiu u regjistrua në programin e NDI-së për Menaxhimin Politik, në 2003 ajo, sakaq, ishte një politikane e zgjedhur aktive në rradhët e PD-së së Elbasanit. Mimoza ka qenë Kryetare e Këshillit Bashkiak nga viti 1996 deri në vitin 2000, dhe tani ajo është Sekretare e Përgjithshme e PD-së Elbasan, Anëtare e Këshillit Bashkiak dhe e Këshillit të Qarkut Elbasan.

Suksesi i Mimosës qëndron në menaxhimin e fushatës zgjedhore vendore të vitit 2003. Ky fakt e bën atë një nga shembujt e pakët të gruas në këtë rol. Ajo qendroi në kontroll të të gjithë hapave të kësaj fushate dhe thotë, "Mua si Zhupiste NDI-ja më tregoi se politika nuk është hobi por profesion." Këto zgjedhje ishin vërtetë model parë në disa aspekte.

Së pari, përzgjedhja e kandidatit për kryetar Bashkie u bë në rradhët e shoqërisë civile dhe për këtë u mor një vendim i përbashkët duke konsultuar të gjithë anëtarësinë që nga forumet drejtuese dhe deri tek anëtarët e thjeshtë. Në të njëjtën mënyrë u veprua edhe për kandidatët për kryetar komunash.

Së dyti, vetë Mimoza trainoi kandidatët për aftësitë e organizimit të fushatës dhe të paraqitjes së tyre në publik. "Gjatë këtyre trainimeve unë vura në zbatim të gjitha ato ide dhe vizione progresiste të marra nga NDI-ja, që nga fushata derë më derë si një mënyrë për të qenë më afër votuesit e deri tek hartimi i një mesazhi të fuqishëm."

Së treti, Mimoza menaxhoi më së miri fondet e pakta financiare duke shfrytëzuar intensivisht burimet njerëzore. Në fakt fushata që ajo drejtoi kishte më pak fonde në krahasim me kundërshtarët e saj. PD-ja fitoi bashkinë e qytetit si dhe 8 nga Komunitatet më të rëndësishme të Elbasanit duke i zënë vendin kandidatit Socialist që kishte qendruar për dy mandate në detyrë.

Tashmë Mimoza po punon për të nxitur pjesëmarrje më të madhe të gruas në politikë dhe po mbështet frymën e tolerancës dhe respektit për opinionet e ndryshme në partinë e saj. Ajo, gjithashtu, është angazhuar për përmirësimin e kapacitetit profesional mes politikanëve dhe autoriteteve politike. "Duhet menaxhuar mirë pushteti në bazë në mënyrë që të arrish në qendër," kështu u shpreh Mimoza Hasekiu.

Nëse Mimoza bën aq progres me këto qëllime sa ç'ka bërë në jetën e saj politike deri tani, nuk ka asnjë dyshim se të shumtë do të jenë ata që do të përfitojnë prej përkushtimit dhe energjisë së saj.

Alma Lahe

Human Rights Union Party



Alma Lahe has been working in the Human Rights Union Party for more than 8 years. She has been the political coordinator and publisher of the party's monthly newspaper, "Demokracia." Since 2002 she has been HRUP's permanent representative to the Central Election Commission.

"NDI's Political Party Development Program is the most qualitative one in Albania; it has been my guide and its results are long term and visionary. I say this based on my professional capacity building from an administrative position to a political one as the political coordinator of the party," Alma says. Her engagement with NDI started in 1999 and continued through the ZHUP 3 program on the political party management that concluded in 2003.

Inspired by the ideas gained in ZHUP, Alma revived the HRUP Youth Forum and started to assume a greater role within the political structures of her party. From 2002 until the local elections of 2003 she became the electoral campaign manager in the party headquarters. "NDI helped me help my party," she says, mentioning the usefulness of the lectures received in ZHUP, such as organizing of an electoral campaign, time management, message development, posters, and leaflets, as well as door-to-door canvassing.

As part of ZHUP, Alma started a project to train political candidates in the 12 prefectures of the country in order for them to be more successful in the next elections. She taught them all the skills gained from NDI. "The result was the best ever achieved by HRUP. We won 8 communes and 3 municipalities, among which the municipality of Poliçan was the most surprising because it has always been a socialist stronghold," she says.

Actually, Alma plans to achieve a cross party agreement regarding increasing the quota of women within political parties. She explains that this opinion was unanimously held by the members of ZHUP 3. It is these very members that are enabling this agreement within their respective parties. "This is another positive indicator of the spirit that NDI is bringing to new politicians," expresses Alma.

Her objective and concern alike remain for the elections of 2005 because she will have to be more on her own in order to organize and ensure the good proceedings of them, because her political bosses will be busy running for parliament. For the moment, at least, Alma is satisfied with her professional investment within her party.

"NDI më ndihmoi mua të ndihmoja partinë time."

Alma Lahe ka më se 8 vjet që punon në Partinë e Bashkimit të të Drejtave të Njeriut. Ajo tashmë është koordinatore politike e partisë dhe botuesja e të përmuajshmes partiake "Demokracia;" gjithashtu, që prej vitit 2002 ajo është dhe përfaqësuese e përhershme e PBDNJ-së në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

"Programi i Zhvillimit të Partive Politike (ZHUP) i NDI-së është programi politik më cilësor në Shqipëri; ai ka qenë udhërrëfyesi im dhe rezultatet e këtij programi janë afatgjatë dhe vizionar. E them këtë duke pasur parasysh ngritjen time profesionale nga një post administrativ në një post politik si koordinatore politike e partisë, " shprehet Alma. Angazhimi i saj me NDI-në filloi në vitin 1999 si dhe vazhdoi edhe më tej në programin ZHUP 3 për menaxhimin e partive politike që përfundoi në vitin 2003.

Në përfundim të kursit të saj të parë në ZHUP-e nxitur nga idetë e marra në të Alma ringriti në PBDNJ Forumin Rinor të kësaj partie. Hap pas hapi ajo filloi të luante një rol edhe më të madh brenda strukturave politike të partisë së saj. Nga viti 2000 e gjer në fushatën e zgjedhjeve vendore të vitit 2003 Alma ishte menaxhere e fushatave zgjedhore në qendër. "NDI më ndihmoi mua të ndihmoja partinë time," shprehet ajo duke përmendur dobinë e të gjithë atyre leksioneve të marra tek ZHUP, që nga organizimi i fushatës zgjedhore, menaxhimi i kohës, hartimi i një mesazhi, posterat, fletë-palosjet si dhe fushatën derë më derë.

Duke qenë pjesë e kursit ZHUP Alma nisi një projekt të saj për të trainuar kandidatët partiak në 12 zona të vendit për arësytën që ata të ishin sa më të suksesshëm në fushatën zgjedhore të rradhës. Ajo përcolli tek këta kandidatë të gjitha njohuritë e fituara tek NDI. "Rezultati i arritur ishte më i miri i arritur ndonjëherë nga PBDNJ. U morën 8 komuna dhe 3 bashki, ndër të cilat ajo e Policanit ishte më e papritura për shkak se ka qenë gjithmonë bastion socialist," thotë Alma.

Aktualisht Alma ka në plan të arrijë të vendosë një marrëveshje ndërpartiake në lidhje me rritjen e kuotës së grave në strukturat politike. Ajo shpjegon se ky mendim është marrë në mënyrë të përbashkët nga të gjithë anëtarët e kursit ZHUP 3. Dhe janë pikërisht këta anëtarë që po bëjnë të mundur këtë lloj marrëveshje brenda partive të tyre. "Ky është një tjetër tregues pozitiv i frymës që përçon tek politikanët e rinj NDI," thotë Alma.

Synimi dhe shqetësimi i saj kryesor për të ardhmen mbeten zgjedhjet e vitit 2005 për arësytën se do ti duhet të mbështetet edhe më shumë tek vetja për organizimin dhe mbarëvajtjen e tyre sepse shefat e saj do të jenë vet duke kandiduar për në parlament. Të paktën, për momentin Alma është e kënaqur me investimin e saj profesional brenda partisë.

Elton Lika Farkë e Madhe



Looking back at what Civic Forum has brought to people is motivating and educational. One person who illustrates this new mentality is Elton Lika. He lives in Farkë e Madhe, a withering military village that consists of long-term locals and newly-arrived Northerners. Social and economic problems mount daily. Elton was born here; he is part of the community and it is here he forged his personality.

Elton was just seventeen when he joined one of the Civic Forum groups. This was a group made up mostly of adults and meetings were held in a bar. Despite this fact Elton made a place for himself quickly, actively taking part and finding respect within the group. Thus, he gained a self-confidence that he can adapt in any environment at any time.

Through the discussion group, Elton's sense of responsibility as a citizen and his personal activity began to develop. He has become sensitive toward the different events in his surroundings. As a result of this, Elton helped establish a youth group solely aimed at transferring to his mates information and ideas that he had gained.

Elton's relation with the local government is that of a simple citizen. He openly expresses disbelief regarding elected officials even though he was a first-time voter in October 2003. He feels impotent at the sight of corruption. "I voted because I felt responsible. But I'd like to have voted filled with inspiration and hope."

Elton sees an important change in himself, and in particular in the respect he feels for others. "Respect makes me feel open-minded, communicate with all the people, and help anyone asking for it. I think my respect is my strongest asset as I try to be someone in life."

Now, Elton is 20 years old and investing in his future. He has a lot of things on his mind. He has a big goal—to be a community leader, someone capable of making a valuable contribution. Then he can fulfill his role as citizen.

The boy who changed

"Votova sepse ndihesha përgjegjës. Por do të doja të votoja me qejf dhe i mbushur me shpresë."

Po të hedhim sytë pas dhe të shohim se ç'i ka sjellë Forumi Civil njerëzve është motivuese dhe edukuese. Një person që mund të ilustrojë këtë mentalitet të ri është Elton Lika. Ai jeton në Farkën e Madhe, një fshat ushtarak që përbëhet nga vendas të hershëm dhe të sapoardhur nga Veriu. Problemet social-ekonomike shtohen çdo ditë. Eltoni ka lindur këtu; ai është pjesë e këtij komuniteti dhe këtu ai ka brumosur personalitetin e tij.

Eltoni ishte vetëm 17 vjeç kur u bashkua me një nga grupet e Forumit Civil. Ky ishte një grup i përbërë më së shumti prej të rriturish dhe taimet i zhvillonin në një kafene. Pavarësisht këtij fakti, Eltoni i bëri shpejt vend vetes, duke marrë pjesë aktive dhe duke gjetur respekt brenda grupit. Kështu, ai fitoi vetbesmin se mund të përshtatej në çfardo lloj ambjenti në çdo kohë.

Me anë të grupit të diskutimit, ndjenja e përgjegjësisë qytetare tek Eltoni dhe tek veprimtaria e tij nisi të zhvillohej. Ai u bë i ndjeshëm ndaj ngjarjeve të ndryshme në ambjentin përreth tij. Si rezultat i kësaj, Eltoni ndihmoi në krijimin e një grupi të rinjsh me të vetmin qëllim që të transferonte tek bashkëmoshatarët e tij informacionin dhe idetë që kish fituar.

Marrëdhënia e Eltonit me pushtetin vendor është ajo e çdo qytetari të thjeshtë. Ai shpreh hapur mosbesimin e tij ndaj zyrtarëve të zgjedhur vendor edhe pse në zgjedhjet e Tetorit 2003, votoi për herë të parë. Ai ndihet i pafuqishëm ndaj korrupsionit që shikon. "Votova sepse ndihesha përgjegjës. Por do të doja të votoja me qejf dhe i mbushur me shpresë."

Eltoni vëren ndryshim të madh Brenda vetes dhe sidomos në lidhje me respektin ndaj të tjerëve. "Respekti më bën të ndihem mendje-hapur, të komunikojë me këdo dhe të ndihmojë cilindo që ka nevojë. Mendoj se respekti është arma ime më e forte teksa përpiqem të jem dikush në jetë.

Tani, Eltoni është 20 vjeç dhe po investon për të ardhmen e tij. Shumë gjëra i vozisin në mendje. Ai ka një qëllim të madh - të bëhet lider komuniteti, dikush që të jetë i aftë të japë kontribut të vlefshëm. Atëherë ai mund të përmbushë rolin e tij si qytetar.

Ndue Marku Shkozet



Ndue Marku, a pediatrician in the Shkozet Health Centre, has been a Civic Forum discussion group member for two years. Ndue looks back on the parliamentary election campaigns as the source of his motivation for citizens to know and do more. "During the 2001 elections, I was part of a campaign where the candidate promised to secure the power supply for the area. He won, but as it so often happens with Albanian MPs," Ndue expresses, "after he got our votes, he never showed up again to fulfil his promise." Ndue was concerned about the way the MP manipulated a promise to get votes. "I felt that someone must wake the community up to this issue."

During his time with Civic Forum, Ndue learned basic information about democracy as well as how to take that information and put it into the practice of community action. He started a door-to-door effort to make residents aware of the need and right to hold their local MP accountable for his 2001 campaign promises.

Ndue knew time and planning would play an important part in his action. "In order to meet with an MP you may be dragged around for months," he says "but altogether we generated power and energy to follow through on our issue." Finally, the MP did meet with the citizens of Shkozet. Forty citizens took part in a meeting during which they reminded the MP of his 2001 campaign promise of a new transformer and new electrical combine. The citizens asked him why nothing had happened so far.

The MP noted that once citizens began to pay for their electrical services, he would ensure that a new transformer was put into place. Seeing an opportunity, Ndue and his colleagues organized an awareness campaign to educate residents about the need to pay their electricity bills and others on a regular basis to secure more consistent services. As a result, citizens in the target area did begin to pay their bills, and the MP did help secure a new transformer for the area.

Over time, the citizens of Shkozet learned that democracy is a balance of rights and responsibilities. The citizens showed their willingness to contribute by participating in meetings and by paying their bills. The MP was called into account. "More important than the achievement of our demand was the sense of confidence the citizens felt about the power and importance of their vote," says Ndue.

Ndue summed up his thoughts this way, "I couldn't limit my responsibility as an active citizen only to my duty of being a good doctor. A good doctor helps heal not only a person but also a community."

Rights and responsibilities

"Më e rëndësishme se sa arritja e kërkesës tonë ishte ndjenja e besimit që qytetarët krijuan për fuqinë dhe rëndësinë e votës së tyre."

Ndue Marku, pediatër në Qendrën Shëndetësore të Shkozetit, është anëtar i grupit të diskutimit të Forumit Civil që prej dy vjetësh. Kur kujton burimin e motivimit lidhur me faktin se qytetarët duhet të dinë dhe të bëjnë më shumë, Ndue ndërmend fushatën e zgjedhjeve të fundit parlamentare. "Gjatë zgjedhjeve të vitit 2001, unë isha pjesë e një fushate në të cilën kandidati premtoi sigurimin e energjisë elektrike për zonën. Ai fitoi, por siç ndodh random me deputët Shqiptarë," shprehet Ndue, "pasi mori votat tona, s'u duk më për të përmbushur premtimin e dhënë." Ndue u shqetësua se si deputeti e manipuloi premtimin për të marrë vota. "Ndjeva se dikush duhet të zgjonte komunitetin lidhur me këtë çështje."

Gjatë kohë së tij në Forumin Civil, Ndue mori informacionin bazë për demokracinë si dhe për mënyrën se si ky informacion të shndërrohej në një praktikë të veprimit të komunitetit. Ai nisi një përpjekje derë-më-derë për ti ndërgjegjësuar banorët mbi nevojën dhe të drejtën e vënies përpara llogarisë deputetin lidhur me premtimin e fushatës së tij të vitit 2001.

Ndue e dinte se koha dhe planifikimi do të luanin një rol të rëndësishëm në këtë veprim. "Për tu takuar me një deputet mund të hiqesh zvarrë për muaj të tërë," thotë Ndue "por të gjithë së bashku ne gjeneruam fuqinë dhe energjinë e duhur për ta çaur deri në fund çështjen tonë." Në fund, deputeti u takua me qytetarët e plazhit. Dyzetë qytetarë morën pjesë në këtë takim ku i kujtuan deputetit premtimin e tij zgjedhor të vitit 2001 për një transformator të ri dhe kabinë. Qytetarët i kërkuan atij se pse nuk ishte bërë gjë deri në atë moment.

Deputeti vërejti se sapo qytetarët të fillonin të paguanin faturat e tyre elektrike, ai do të siguronte një transformator të ri. Ndue dhe kolegët e tij, duke e parë këtë si një mundësi, organizuan një fushatë ndërgjegjësuese për të edukuar banorët rreth nevojës për të paguar faturat elektrike dhe detyrimet e tjera rregullisht në mënyrë që të siguronin shërbim të qendrueshëm. Si rezultat, qytetarët në zonën e shënjestruar vërtetë filluan të paguanin faturat e tyre, dhe deputeti vetë ndihmoi për sigurimin e transformatorit të ri për zonën.

Me kalimin e kohës, qytetarët e plazhit mësuuan se demokracia është një ballancë mes të drejtave dhe përgjegjësisë. Qytetarët treguan gatishmërinë e tyre për të kontribuar duke marrë pjesë në takime dhe duke paguar faturat e tyre. Deputeti u vu përpara llogarisë.

Ja si i përmbledhë Ndue mendimet e tij, "Unë nuk mund të kufizoja përgjegjësinë time si një qytetar aktiv vetëm me të qënit doktor i mirë. Një doktor i mirë nuk shëron vetëm një person por edhe një komunitet."

Të drejta dhe të përgjegjësit

Sandër Marku Democratic Party



Sandër Marku, the Democratic Party Chairman of Lezha, started his involvement in politics quite recently. Yet, it isn't by chance that he has now found himself the leader of Lezha Democrats. He attended the course on the Development of Political Party Leaders organized by NDI and has also been trained on Executive Councillors Management. He was able to blend the skills gained during these courses with his personal virtues in order to achieve the high position he now enjoys.

Sandër had the courage to run for chairman against other Democrats that had more experience in party politics. He relied on his personal skills and on the contact he had made as a doctor. First, using his public speaking skills, he put his message across to party members. After that, he used leaflets and went "door-to-door" to enlist the trust of the Party membership as well as to establish the image of a New Politician. All this was realized without the large funds that other, more experienced candidates enjoyed. When asked by his stronger democrat rivals how it was possible he won, he simply showed his asphalt-covered, pebble-gnawed shoes.

Sandër aspires for political and democratic ethics within his party's structure and his plans for sensitizing and activating the party's membership are numerous. Yet, any such efforts would be useless without adopting the principle of "one member one vote." He also stresses the importance of establishing a standard for political ethics and of increasing transparency to voters.

Even though Sandër has aspirations for higher office - perhaps even running for parliament at some point in the future - he does not view his political position as a means for personal gain. "To me, politics is an art and I want to retire in Lezha." Whether he is representing constituent interests at a local or national level, he knows that pluralism and a true democratic process are the key ingredients to make his party strong.

Walk a mile in his shoes

"Për mua çdo leksion i marrë nga NDI ka qenë gjë e re dhe falë saj unë jam Kryetar i PD-së në Lezhë."

Sandër Marku, Kryetari i Degës së Partisë Demokratike në Lezhë, e nisi përfshirjen e tij në politikë së voni. Sidoqoftë, nuk është e rastit që tani është në krye të Demokratëve të Lezhës. Sandri ka ndjekur kursin për Zhvillimin e Udhëheqësve të Partive Politike të zhvilluar nga NDI dhe gjithashtu është trainuar për Menaxhimin e Këshilltarëve Ekzekutiv. Ai ishte i zoti të kombinonte aftësitë e fituara në këto kurse me cilësitë e tij vetjake për të arritur në pozicionin e lartë që tashmë gëzon.

Sandri pati kurajon të kandidonte për kryetar krahas Demokratëve të tjerë më të hershëm se ai në politikën partiake. Ai u mbështet tek aftësitë e tij dhe tek kontaktet e krijuara si mjek. Së pari, duke përdorur aftësinë e të folurit në publik, ai arriti të përcillte mesazhin e tij tek anëtarësia e partisë. Pas kësaj, ai përdori fletë-palosjet dhe shkoi "derë-më-derë" për të fituar besimin e anëtarësisë Demokrate dhe për të krijuar imazhin e Politikanit të Ri. Të gjitha këto u realizuan pa pasur fonde të mëdha sikundër kishin kandidatët më me përvojë se ai. Kur u pyet nga rivalët e tij më të fortë demokrat se si ishte e mundur që kish fituar, ai thjesht u tregoi atyre këpucët e brejtura prej gurëve dhe asfaltit.

Sandri aspiron për një etikë politike dhe demokratike brenda strukturës së partisë së tij dhe planet e tij për të ndërgjegjësuar dhe aktivizuar anëtarësinë partiake janë të shumta. Por, çdo përpjekje e tillë do të ishte e kotë pa rrokjen e parimit "një anëtarë një votë." Gjithashtu, ai thekson rëndësinë e krijimit të një standarti të etikës politike dhe rritjes së transparencës ndaj votuesit.

Edhe pse Sandri aspiron për post më të lartë - madje ndoshta dhe për parlament në një të ardhme të afërt - ai nuk e shikon postin e tij politik si një mjet për përfitime personale. "Për mua politika është art dhe unë dua të dal në pension në Lezhë." Si në rastin kur ai përfaqëson interesin e zgjedhësve në nivel vendor ashtu edhe në atë qendror, ai e di se pluralizmi dhe procesi i vërtetë demokratik janë përbërësit bazë për ta bërë të fortë partinë e tij.

Eci milje me këpucët e tij

Elvis Mataj Socialist Movement for Integration



Elvis Mataj first joined Albania's Socialist Party when he was 16 years old. Since then, he has held a number of significant positions. In 1996 he became a member of Tirana's Socialist Steering Committee and from 2003 until February 2004 was Deputy Chairman of the Party's Youth Forum. He is presently a leading member of Albania's Socialist Movement for Integration (SMI) and one of its Youth Forum leaders.

Elvis joined NDI's political party programs from 1998 to March 2004. "To me, NDI has been a proper political school. It taught us the meaning of political culture, code of ethics, code of conduct that were unknown to us. NDI presented us with the chance to unfurl our individual values as our parties are lacking the methods to select new figures and the room to express new skills and ideas."

In the 2001 parliamentary elections, Elvis worked on Et'hem Ruka's successful campaign, putting into actual practice many of the ideas learned from lectures at NDI such as door-to-door canvassing, leaflets and posters.

During his time in his Party's Youth Forum, Elvis organized many political training sessions in order to transmit the knowledge taken from NDI programs. "NDI taught us how to be 'winners' in a time when the political competition has become tougher and the electoral turn-outs even tighter. At NDI, I learned that the real choice for Albanian politicians is not between old and new politicians but between old and new ideas."

Elvis' future is closely linked to that of SMI and in next June's Parliamentary Elections he may well run as a candidate. No doubt he will continue to play a major role in the future development of its youth movement.

New ideas, new values

"Tek NDI mësova se nuk ka politikanë të vjetër dhe të rinj por ka ide të vjetra dhe të reja."

Elvis Mataj, fillimisht u aktivizua në Partinë Socialiste të Shqipërisë kur ishte vetëm 16 vjeç. Që atëherë ai ka pasur një sërë postesh të rëndësishme. Në vitin 1996 ishte anëtar i Këshillit Drejtues të Tiranës dhe nga viti 2003 deri në Shkurt të vitit 2004 ka qenë Nën Kryetar i Forumit Rinor Euro-Socialist të Shqipërisë. Aktualisht, ai është anëtar i Lëvizjes Socialiste për Integrim (LSI) si dhe një nga drejtuesit e Forumit Rinor të saj.

Elvisi u aktivizua tek programi i NDI-së për Zhvillimin e Partive Politike që gaë viti 1998, deri në vitin 2004. "NDI për mua ka qenë një shkollë e mirëfilltë politike. Na mësoi ç'është kultura politike, kodi i etikës, i sjelljes dhe i paraqitjes gjëra që ishin të panjohura për ne," vazhdon ai. "NDI për ne ishte një shans për të shpalosur vlerat tona individuale sepse në partitë tona mungojnë metodat e selektimit të figurave dhe hapësirat për të shprehur aftësitë dhe ide të reja."

Në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2001, Elvisi punoi në fushatën e suksesshme zgjedhore të Z. Et'hem Ruka, duke vënë në jetë shumë nga idetë e mësuara në NDI, që nga kontakti derë më derë hartimi i fletë-palosjeve informative dhe posterat.

Gjatë gjithë kohës në Forumin Rinor të partisë së tij, ai ka organizuar seanca të shumta trainimesh politike në mënyrë që të gjitha njohuritë e marra tek NDI ti përcillte tek të tjerët. "NDI na mësoi se si të jesh fitues në një kohë kur konkurrenca politike është shumë e fortë dhe rezultatet zgjedhore bëhen gjithnjë e më të ngushta. Tek NDI mësova se nuk ka politikanë të vjetër dhe të rinj por ka ide të vjetra dhe të reja."

E ardhmja e Elvisit është e lidhur ngushtë me LSI-në dhe në zgjedhjet e ardhshme parlamentare ai do të kandidojë për këtë force politike. Dhe, sigurisht, do të luajë një rol kryesor në zhvillimin e lëvizjes rinore të kësaj partie.

Ide të reja, vlera të reja

Rauf Merko Sauk



We found Rauf Merko reading a paper with a pen in his hand. Though we didn't know each other he received us with much respect. He lives in the southern part of Sauk, just outside of Tirana City. Sauk is made up entirely of newly-arrived people. In fact, until ten years ago, it was a vineyard and orchard, no one lived there at all.

Rauf was a participant in Civic Forum for more than a year and a half. He had been invited to take part in the first Super Citizens' training, but his wheelchair limited his mobility and he did not take part. Despite his physical limitations, Rauf helped in the creation of the group and organized many meetings. Rauf gave the group his energy.

For the last two years, he put the skills he gained in Civic Forum to use. Rauf called on the mayor of Sauk to take part the community meetings no fewer than eight times. Each time, the mayor has come. These meetings addressed a range of community issues, such as water supply, electricity and roads. Above all these gatherings help to establish and strengthen the relationship between citizens and the local government of Sauk.

Rauf's personal goal is the improvement of his community living. But, he is among the few people that have a clear vision for this. "If I had a couple of more friends, I would ask for meetings with the local government until my neighborhood was as beautiful as a flower."

Rauf also has a clear vision of what a citizen should be and has the inner strength needed to achieve this vision. "The last election day I went to vote with a taxi. I wonder how on earth the normal people that can walk do not go to vote." But Rauf does not dwell on limitations. He is an active member of the paraplegic association. He wishes to contribute wherever he can.

When we parted Rauf made a request: "I feel that my community still has a great need to build its capacities. And I ask you, if you have a new program, to come here and implement it."

Clear vision and inner strength

Habitem me këta që ecin vetë dhe nuk shkojnë të votojnë."

Ne e gjetëm Raufin duke lexuar gazetën me laps në dorë. Edhe pse nuk e njihnim njeri tjetrin ai na priti me shumë respekt. Raufi jeton në pjesën jugore të Saukut, pak jashtë qytetit të Tiranës. Sauku përbëhet tërësisht nga të sapoardhur. Faktikisht, deri dhjetë vjetë më parë, ai ka qenë i tëri vresht dhe askush nuk banonte aty.

Raufi ka qenë pjesëmarrës në Forumin Civil për më shumë se një vit e gjysmë. Ai është ftuar të marrë pjesë në trainimin e parë të Super Qytetarëve, por karroca e invalidit ja kufizonte lëvizjen ndaj dhe nuk morri pjesë. Pavarësisht kufizimeve fizike, Raufi ndihmoi në krijimin e një grupi dhe organizoi shumë takime. Raufi i dha grupit energjinë e tij.

Këto dy vitet e fundit, ai i ka parktikuar aftësitë që mori në Forumin Civil. Raufi ka thirrur për plotë tetë herë kryebashkiakun e Saukut që të marrë pjesë në takimet e komunitetit. Dhe çdo herë kryebashkiaku erdhi. Këto takime i drejtoheshin një sërë shqetësimesh të komunitetit si ujë i pijshëm, energjia dhe rrugët. Por mbi të gjitha këto takime ndihmuan në krijimin dhe forcimin e marrëdhënies ndërmjet qytetarëve dhe pushtetit vendor në Sauk.

Qëllimi vetjak i Raufit është përmirësimi i jetesës së komunitetit të tij. Por ai është mes të paktëve njerëz që kanë një vision të qartë për këtë. "Po të kisha mundësinë të merrja edhe dy shokë të tjerë do të kërkoja takime me pushtetin lokal derisa ta bëja lule këtë lagje."

Gjithashtu, Raufi ka të qartë vizionin e të qenit qytetar dhe forca e brendëshme për të arritur këtë vizion është e madhe. "Në votimet e fundit shkova me taksì. Habitem me këta që ecin vetë dhe nuk shkojnë të votojnë." Por Raufi nuk mjaftohet me kaq. Ai është një anëtar aktiv i shoqatës së paraplegjikëve. Ai dëshiron të kontribuojë aty ku ka mundësi.

Kur u ndamë Raufi kishte një kërkesë. "E ndjej që komuniteti im ende ka nevojë për të rritur kapacitetin e tij. Dhe ju kërkoj juve që nëse keni ndonjë program të ri, të vini edhe tek ne ta zbatoni."

Vizion i qartë dhe fuqi e brendshme

Haxhi Muka Kamez



It was September of 2000 when we bumped into Haxhi Muka on the street where he was talking to some folks. He was an older man, medium height, slightly hunched and quiet. His eyes were his most impressive feature, soft, smiling and probing. We told him of our intentions with Civic Forum and his eyes brightened, "That's what's needed," he said, "I am at your disposal."

Haxhi quickly took on the role of promoting the citizen discussion group. Not only did he make sure that no one missed the discussions, he often brought in new people. He always took extra copies of the materials we distributed, because, he said, "I read it with my family and give away other copies to my friends." His efforts resulted in the creation of four other Civic Forum discussion groups in Bathore.

Haxhi's main concern for his community is the re-emergence of blood feuds. He has stature and influence in his community and learned to connect these qualities with techniques he learned in Civic Forum. "Since the start, I understood that what we did in Civic Forum would help in reconciliations. I began to use facilitation techniques, the rules of discussion and conflict mediation. Now I feel comfortable because I know how to handle even extreme situations."

The reconciliation of one conflict is the best example of this. The feud began randomly enough in 1996 when one family narrowed the road. Along the way, the other family retaliated with a beating. The violence flared and by 2000 when Haxhi first intervened, both families had suffered one death. "I did all I could, but I couldn't reconcile them," he noted sadly. Within a year, the number of murders doubled, others were in jail, others were hiding from the law.

By this time, Haxhi and the others in Civic Forum had been trained in community organizing. "Now I knew how to make a strategic plan," he says. He revisited the blood feud and, working with his son Sherif, designed a strategic plan to reconcile the families. "In the series of actions, we started with the easiest issues and moved to the hardest, working from the specific to the general." At the final meeting, true reconciliation was achieved between the two families. Each family agreed to specific obligations and each family signed to those responsibilities. There are 36 signatures from both parties. This record holds the power of law. Each family has respected it and as a result, the incarcerated were released and Interpol repealed arrest warrants on the wanted persons.

Haxhi continues his work and people keep knocking on his door for advice. Haxhi, as always, is willing to offer whatever help he can, using his influence and the skills he sharpened during his time with Civic Forum.

Reconciling blood feuds

"Në serinë e veprimeve ne filluam me çështjet më të lehta për tek më të vështirat."

Ishte Shtatori i vitit 2003 kur e takuam për herë të parë Haxhi Mukën. U ndeshëm me të në rrugë kur po fliste me disa njerëz. Ai një burrë në moshë, me gjatësi mesatare, i qetë dhe pak i kërrusur. Gjëja që të bënte më shumë përshtypje ishin sytë e tij, të butë, të qeshur dhe zhbirues. Ne i treguam qëllimin tonë për Forumin Civil dhe sytë i shndrritën, "Kjo është ajo që duhet," tha ai, "Jam në dispozicionin tuaj."

Haxhiu shumë shpejt mori rolin e promotorit të grupit të diskutimit qytetar. Jo vetëm që nuk mungonte në asnjë diskutim por shpesh sillte dhe njerëz të rinj. Gjithmonë merrte kopje shtesë të materialeve që ne shpërndanim, sepse, thoshte ai, "Unë i lexoj ato me familjen time dhe u jap kopjet e tjera shokëve të mi." Përpjekjet e tij rezultuan në krijimin e katër grupeve të tjera diskutimi të Forumit Civil në Bathore.

Shqetësimi i tij kryesor ishte rishfaqja e gjakmarrjeve. Ai gëzon respekt dhe ka shumë ndikim në komunitetin e tij dhe mësoi se si të ndërlikonte këto cilësi me teknikat e fituara në Forumin Civil. "Që në fillim, e kuptova se ajo që bënim në Forumin Civil do të më ndihmonte tek pajtimet. Unë fillova të shfrytëzojë teknikat lehtësuese, rregullat e diskutimit dhe ndërmjetësimin e konfliktit. Tani, unë ndihem rehat sepse di të përballojë situata shumë të vështira."

Pajtimi i nje konflikti është shembulli më i mirë i kësaj pune. Hasmëria filloi për arsye të rëndomta në vitin 1996, kur njëra nga familjet ngushtoi rrugën. Në sherr e sipër njëra palë ia ktheu duke rrahur një nga pala tjetër. Dhuna u rrëmbye dhe në vitin 2000 kur Haxhiu ndërhyri fillimisht, të dyja familjet kishin nga një të ndjekur. "Unë bëra ç'munda, por nuk i pajtova dot," thotë me keqardhje ai. Brenda një viti, numri i vrasjeve u dyfishua, të tjerë u futën në burg dhe të tjerë madje ishin në kërkim.

Në këtë kohë, Haxhiu dhe të tjerë në Forumin Civil ishin trainuar për organizimin e komunitetit. "Tani unë e dija se si të bëja një plan strategjik," thotë ai. Haxhiu iu rikthye pajtimit dhe duke punuar bashkë me të birin, Sherifin, hartuan një plan strategjik për të pajtuar këto familje. "Në serinë e veprimeve ne filluam me çështjet më të lehta për tek më të vështirat, duke punuar nga specifika tek e përgjithshmeja." Në takimin përfundimtar u arrit pajtimi i vërtetë mes dy familjeve. Secila prej tyre pranoi detyrimet e veçanta dhe secila prej tyre i nënshkroi ato. Ka 36 firma nga të dyja palët. Ky dokument ka fuqinë e ligjit. Secila familje e respektoi atë dhe si rrjedhojë, të burgosurit u liruan dhe Interpoli e anuloi mandatin për të kërkuarit.

Haxhiu e vazhdon punën e tij. Njerëzit vazhdojnë të trokasin tek ai për këshilla. Dhe Haxhiu, si gjithmonë, është i gatshëm të ofrojë çdo lloj ndihme mundet, duke përdorur ndikimin dhe aftësitë që i thelloi gjatë kohës që qëndroi me Forumin Civil.

Reis Mulita

Social Democratic Party



Reis currently works as the Chief of Cabinet at the Ministry of Work and Social Affairs. He is also the Media and Foreign Relations Coordinator of Albania's Social Democratic Party (SDP) as well as being a member of his Party's National Council.

Reis first became involved with NDI in 1998 as a participant on the Political Party Development Program (ZHUP) and was in the Political Management Program between 2003 and 2004. "These programs were significant both in content and form. In the first place, they were composed of members of the whole political spectrum that were participating to learn more about western parliamentary democratic practice in order to apply such skills here."

Immediately after the first ZHUP program, inspired by the spirit of cross-party cooperation engendered at NDI, Reis initiated a series of local level roundtable discussions on the decentralization of local government. These discussions took place throughout Albania and were funded by the Westminster Foundation.

"NDI's presence in Albania has been and continues to be indispensable to the formation of Albania's political class—especially to developing a new leadership mentality," Reis says. He stresses as very important the lectures given at NDI regarding the media as they served him well in his work within his party. He also served as the party's official spokesman and organized all press conferences and prepared all media materials during elections.

Reis says, "NDI was part of my political success." He explains that in all electoral campaigns he was involved in, he has rigorously applied the skills learned during NDI lectures and seminars. He also mentions the importance of door-to-door canvassing and public speaking training as key elements of his electoral campaign when he ran for parliament. Reis says, "My result in the electoral zone was higher than the result for my party nationally."

As for the future, Reis plans to run again for parliament and also hopes to rise further within the ranks of his party.

"Rezultati im personal në zgjedhje ka qenë më i lartë sesa ai i partisë që përfaqësojë."

Reis Mulita është Drejtor i Kabinetit të Ministrit të Punës dhe Cështjeve Sociale. Gjithashtu, ai është Koordinator i Medias dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Partinë Social-Demokrate të Shqipërisë si dhe Anëtar i Këshillit Kombëtar të saj.

Reis Mulita u bashkua me NDI që në fillim të programit të saj për Zhvillimin e Partive Politike (ZHUP) në vitin 1998 si dhe mori pjesë në Programin e Menaxhimit Politik nga viti 2003 në vitin 2004. "Këto programe ishin shumë domethënëse, si nga përmbajtja ashtu edhe nga forma. Në rradhë të parë në atë kurs bënë pjesë anëtarë nga i gjithë spektri politik shqiptar që kishin ardhur për të mësuar mbi praktikën parlamentare të demokracive perëndimore për ti zbatuar këtu.

Aty për aty, Reisi, pas program të parë ZHUP, i frymëzuar nga fryma e bashkëpunimit ndër-partiak që mori tek NDI, nisi një seri tryezash të rrumbullakta në nivel vendor që kishin të bënin me decentralizimin e pushteti vendor dhe me rolin e lidershit të ri në politikë. Këto tryeza u zhvilluan në mbarë Shqipërinë me fonde të dhëna nga Fondacioni Westminster.

"Prezenca të tilla si NDI janë shumë të domosdoshme për formimin e klasës politike shqiptare - veçanërisht të lidershit me mendësi të re," thotë Reisi. Si shumë të rëndësishëm, ai përmend leksionet që ka marrë në NDI në lidhje me median për arësytën se këto leksione i kanë shërbyer atij drejtpërdrejtë në veprimtarinë e tij të përditshme brenda partisë. Gjithashtu, ai ka ushtruar rolin e Zëdhënësit Zyrtar të partisë dhe ka organizuar të gjitha konferencat për shtyp të lidershit social-demokrat si dhe ka përgatitur të gjitha materialet për median në zgjedhje.

Reisi thotë se, "NDI ka qenë pjesë e suksesit tim politik." Ai shpjegon se në fushatat e ndryshme zgjedhore të zhvilluara në vendin tonë, ka zbatuar me përpikmëri të gjitha leksionet dhe aftësitë e marra tek NDI. Ai, gjithashtu, përmend kontaktin derë më derë me votuesin si dhe aftësinë e të folurit në publik si elementë kryesor të fushatës së tij kur kandidonte për deputet. "Dhe rezultati im personal në zgjedhje ka qenë më i lartë sesa ai i partisë që përfaqësojë," thotë ai.

Për të ardhmen Reisi synon të kandidojë sërish si deputet dhe gjithashtu ushqen shpresën për tu ngritur në detyrë brenda strukturës të brendshme të PSD-së.

Të zgjerojmë dialogun

Flamur Noka

Democratic Party



Flamur Noka is Vice Chairman of the Democratic Party Youth Forum and also a member of its National Council. By the time he joined NDI's Program for the Development of the Political Parties (ZHUP), he was already carrying out these roles in the party, "Nevertheless, NDI helped me to further strengthen and sharpen my organizing and management skills."

"I highly value the lectures received in ZHUP, especially those dealing with the electoral campaign management. The most valuable lectures were the ones regarding the attraction and activation of volunteers during electoral campaigns and door-to door canvassing."

As Vice Chairman of the DP Youth Forum, he explains that the ZHUP lectures on youth were also of special interest to him. As a result he says that there were scores of meetings organized among different democratic candidates and the youth in order to draw the opinion of such a massive and energetic part of the society. These ideas helped his party candidates draft their electoral platforms in a more specific, realistic and convincing way for the youth. At the same time, during these meetings, Flamur says, special attention was paid to the selection of young candidates that presented future potential for the party. "Rarely," he says, "were the candidates presented by the Forum to the party rejected. Out of 22 commune mayor candidates, 17 won on the 2003 local election and 3 out of 5 mayoral candidates also won." But he stresses that this result was also brought about after intensive pre-electoral work by Flamur and his colleagues in order to train these individuals with the skills and techniques of a new politician, which Flamur deepened at NDI.

"I must mention the visionary and progressive ideas taken by the ZHUP lectures on the democratization of the political parties through the principle "one member one vote;" or the spirit of cross-party understanding which would be enabled at best by the increase of the women force within the parties."

Currently, Flamur is directing all his energies to the 2005 parliamentary elections. He believes that his party is going to be as successful as in 2003 local elections.

Building on existing skills

Gjëja që më ka vlejtur më shumë në këtë fushë, ishte thithja dhe aktivizimi i vullnetarëve gjatë zhvillimit të fushatë zgjedhore si dhe trokitja derë më derë."

Flamur Noka është Zv/Kryetar i Forumit Rinor të Partisë Demokratike të Shqipërisë si dhe anëtar i këshillit kombëtar të kësaj partie. Ai e ka nisur herët aktivizimin e tij në këtë forcë politike si anëtarë i thjeshtë i saj. Në kohën që Flamuri iu bashkua Programit të Zhvillimit të Partive Politike (ZHUP) të NDI, në vitin 2002, ai sakaq i kryente të dyja këto role në parti, "Megjithatë unë i forcova dhe i mpreha edhe më shumë aftësitë e mija organizuese dhe drejtuese tek NDI."

"Vlerësoj së tepërmi leksionet e marra tek ZHUP sidomos ato që trajtonin organizimin e një fushate zgjedhore. Gjëja që më ka vlejtur më shumë në këtë fushë, ishte thithja dhe aktivizimi i vullnetarëve gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore si dhe trokitja derë më derë," tha ai.

Duke qenë zv/kryetar i Forumit Rinor të PD-së ai shpjegon se edhe leksionet e ZHUP në lidhje me rininë kanë përbërë interes të veçantë për të. Si rrjedhojë, Flamuri thotë se janë zhvilluar një mori takimesh mes kandidatëve të ndryshëm demokrat me rininë në mënyrë që të vilej mendimi i kësaj shtrese masive dhe energjike të shoqërisë. Më pas këto opinione ndihmuan kandidatët e partisë së tij të hartonin platformat e tyre zgjedhore në një mënyrë sa më specifike, reale dhe bindëse për të rinjtë. Në të njëjtën kohë gjatë këtyre takimeve Flamuri tregon se u kushtoj vëmendje e veçantë seleksionimit të figurave rinore që paraqesnin potenciale të mundshme për partinë. "Dhe jo më kot," thotë ai, "asnjë nga kandidatët që Forumi i paraqiti partisë nuk u refuzua prej saj. Dhe nga 22 kandidatët për kryetar komunash 17 prej tyre fituan në zgjedhjet e 2003, si dhe 3 nga 5 kandidatët për kryebashkiak." Por, ai thekson se ky rezultat ka qenë frut i një pune të përshtur parazgjedhore nga ana e tij dhe kolegëve të tij për ti trainuar këta individë me aftësitë dhe teknikat e një politikani të ri, të cilat Flamuri i thellojë tek NDI.

"Duhet të përmend idetë vizionare dhe progresiste të përcjella nga leksionet e ZHUP për demokratizimin e partive politike me anë të parimit "një anëtar, një votë"; ose për frymën e mirëkuptimit ndërpartiak gjë që do ta kryente më së miri shtimi i faktorit grua brenda rradhëve të partive politike."

Tani, Flamuri i ka hedhur sytë dhe ka përqendruar tërë energjinë e tij tek zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2005 për të cilat thotë besimplotë se do të jenë po aq të suksesshme për partinë e tij sa edhe ato vendore të vitit 2003.

Të çosh më tej aftësit

Hafsa Shehu Mullet



"Before becoming part of Civic Forum, I was an indifferent person void of any courage," says Hafsa Shehu, nurse in Mullet health center. "At first, we were only a small group, now, we are a lot more, equipped not only with knowledge of democracy but also with the techniques required to take concrete actions for the common good."

"The introduction with Civic Forum program made me see the skills of community organizing and cooperation are within me. Step by step I achieved a greater maturity as a citizen." The change in Hafsa's thinking is deep. "To me, democracy is not just a theoretical thing like a book that is read and then left to one side."

Hafsa and others in her community applied the lessons of citizen action in a number of ways. For example, citizens demonstrated their willingness to cooperate with the local government through the creation and distribution of a Mullet community platform. In only three weeks they filled the surveys, listed the priorities, and designed the final platform. When it came time to present the platform to the candidates, one of the political representatives said, "This platform is fantastic and also a achievement of the community, but don't hand it over at the other political forces." But she did!

The citizens in Mullet realize they can develop and share a vision that they can "lean on to improve community lives. I say this based on my experience with a community that has gone through a lot of changes year after year." They hold discussions with local officials on a regular basis, not with "the aim of finding guilt, but at getting to common terms to improve the community."

Hafsa has used her additional training as an Engaged Citizen to create even more momentum in Mullet. She has become very effective at getting all sides to contribute to a project. For example, one community priority was improving a local road. Hafsa used her skills to make this idea a reality. "In addition to people in the community, we also had the commune as our partner. Both parties gave concrete contributions to the road reconstruction.

At the end of our conversation Hafsa said, "One needs no guide with a village in sight.' In other words, the change in our community is obvious."

From Education to Action

"Fshati që duket nuk do kallauz."

"Përpara se të bëhesha pjesë e Forumit Civil, unë isha një person indiferent pa kurajo," thotë Hafsa Shehu, infermiere në qendrën shëndetësore të Mulletit. "Në fillim, ishim vetëm një grup i vogël, tani, ne jemi shumë më tepër, të pajisur jo vetëm me njohuri për demokracinë por gjithashtu dhe me teknikat e kërkuara për të ndërmarrë veprime konkrete për të mirën e përbashkët."

"Prezantimi me Forumin Civil më bëri të shoh aftësitë e organizimit të komunitetit dhe bashkëpunimit brenda meje. Hap pas hapi unë arrita një pjekuri më të madhe si qytetare." Ndryshimi në mendimin e Hafsas është i thellë. "Për mua demokracia nuk është vetëm diçka teorike si një libër që e lexon dhe e lë mënjanë."

Hafsaja dhe të tjerë në komunitetin e saj kanë zbatuar mësimet e veprimit qytetarë në një sërë mënyrash. Për shembull, qytetarët demonstroi vullnetin e tyre për të bashkëpunuar me pushtetin vendor me anë të krijimit dhe shpërndarjes së platformës së komunitetit të Mulletit. Në vetëm tre javë ata plotësuan pyetësorët, listuan prioritetet dhe hartuan platformën përfundimtare. Kur erdhi koha për t'a paraqitur platformën tek kandidatët, një prej përfaqësuesve politikë tha, "Kjo platformë është fantastike dhe gjithashtu arritje e komunitetit, por mos ia jepni forcave të tjera politike." Por, në fakt, ajo ia dha!

Qytetarët në Mullet e kuptojnë se ata mund të zhvillojnë dhe të ndajnë një vizion ku mund "të mbështeten për të përmirësuar jetën e komunitetit. Unë them këtë duke u bazuar në përvojën time me një komunitet që ka pësuar shumë ndryshime vit pas viti." Ata bëjnë diskutime me zyrtarët vendor rregullisht, dhe jo me "qëllimin për të gjetur fajtorin por për të gjetur gjuhën e përbashkët për të përmirësuar komunitetin."

Hafsaja ka përdorur aftësitë e saja shtesë si Super Qytetare për të krijuar një hov edhe më të madh në Mullet. Ajo është bërë tepër e efektshme në organizimin e të gjitha palëve për të kontribuar në një projekt. Për shembull, një nga prioritetet e komunitetit ishte përmirësimi i një rruge lokale. Hafsaja përdori aftësitë e saj për ta bërë këtë ide realitet. "Përveç njerëzve të komunitetit ne gjithashtu patëm edhe komunën si partner. Të dyja palët dhanë kontributin e tyre konkret për rindërtimin e rrugës."

Në fund të bisedës tonë Hafsa tha, "'Fshati që duket nuk do kallauz,' sepse ndryshimi në komunitetin tonë është i dukshëm."

Atlie Xuna Synej



"Civic Forum taught me two valuable lessons: First, the information one takes should be shared with others. Second, in dealing with a community issue it is not worth complaining, accusing or finding guilt. It is worth establishing dialogue, cooperation with other citizens and the local government," says Atlie Xuna, at right.

Atlie is the accountant of the Synej commune in Kavaje. For three years she and other women participated in Civic Forum. "We learned how to protect our rights and interests. We learned how to enter into a dialogue based on respect and communication. Together we built our vision for a better life," says Atlie.

The women of Synej challenged the local patriarchal mentality, showing that women can be initiators of change. They identified issues of community concern by going out and talking with neighbors, friends and relatives. In June 2003, Atlie and other Civic Forum activists in Synej used a simple survey tool to assess and design a platform of local priorities. They administered 120 surveys in 6 villages and submitted their findings to political parties and candidates in advance of the October local elections.

"We couldn't stop. The platform gave us confidence and motivation. It was just the starting point for a series of activities," expresses Atlie. In August 2003, Atlie and five other platform designers advocated their priorities to the local council and secured funding in the 2004 budget for four priorities: the lighting of Rrikaj, health centers in Hajdaraj and Bago, and the installation of a sewage canal system in Synej.

A few months later, the citizens invited candidates to local debates to explore how these candidates would pursue the local priorities. One candidate was so impressed that he took on the citizens' platform as his own, and won the elections. Now, these priorities are being implemented by the local government under the careful monitoring of citizens who hold accountability town hall meetings with local officials.

Recently, Atlie and the other activist citizens of Synej drafted a proposal to create a public information office in the commune. They expect its approval. "Our project does not aim at building the office premises proper. It aims at achieving a relationship where the local government informs the citizens and regularly includes them in the decision taking process."

Communities need dialogue

"Ne mësuam se si të mbronim të drejtat dhe interesat tona."

"Forumi Civil më ka dhënë dy mësimë të vlefshme: Së pari, informacionin që merr duhet ta ndash me të tjerët. Së dyti, kur merresh me një çështje në komunitet nuk do të thotë të ankoresh, të akuzosh ose të gjesh fajtorët. Të merresh me një çështje do të thotë të dialogosh, të bashkëpunosh me qytetarët e tjerë dhe pushtetin," thotë Atlie Xuna. (në fotografinë djathtas)

Atlia është kontabilistja e komunës Synej në Kavajë. Prej tre vjetësh ajo dhe gra të tjera kanë marrë pjesë në Forumin Civil. "Ne mësuam se si të mbronim të drejtat dhe interesat tona. Ne mësuam si të hynim në një dialog të bazuar tek respekti dhe komunikimi. Së bashku ne ndërtoam vizionin tone për një jetë më të mirë," thotë Atlia.

Gratë e Synej sfiduan mentalitetin patriarkal, duke i treguar të gjithëve se gratë mund të jenë nismëtare të ndryshimit. Ato identifikuan çështje shqetësuese për komunitetin duke takuar dhe duke folur me fqinjët, miqtë dhe të afërmit e tyre. Në Korrik 2003, Atlia dhe aktivistë të tjerë të Forumit Civil në Synej përdorën një mjet të thjeshtë pyetësori për të vlerësuar dhe hartuar platformën e prioritetëve vendore. Ata administruan 120 pyetësorë në 6 fshatra dhe dorëzuan gjatjet e tyre tek partitë politike dhe kandidatët përpara zgjedhjeve vendore të Tetorit.

"Ne nuk mund të ndaleshim. Platforma na dha besim dhe motivim. Ajo ishte vetëm fillimi i një sërë veprimtarish," shprehet Atlia. Në Gusht 2003, Atlia dhe pesë hartues të tjerë të platformës mbrojtën prioritetet e tyre përpara këshillit vendor dhe siguruan fondet në buxhetin e vitit 2004 për katër nga këto prioritetet: ndriçimi i Rrikaj, qendra shëndetësore në Hajdaraj dhe Bago, si dhe kanalizimet në Synej.

Pak muaj më pas, qytetarët ftuan kandidatët në një debat për të eksploruar si këta kandidatë do të zbatonin prioritetet vendore. Një kandidat mbeti aq i mbresuar sa që e mori platformën qytetare si të vetën dhe fitoi zgjedhjet. Tani, këto prioritetet janë duke u zbatuar nga pushteti vendor nën vëzhgimin e kujdesshëm të qytetarëve që bëjnë takime llogaridhënëse me zyrtarët e pushtetit vendor.

Së fundi, Atlia dhe qytetarët e tjerë aktivistë të Synej hartuan një propozim për krijimin e një zyre të informimit publik në komunë. Ata po presin aprovimin e tij. "Projekti ynë nuk ka si qëllim ndërtimin e një ndërtese në vetvete. Ai synon të krijojë një marrëdhënie ku pushteti vendor të informojë qytetarët dhe ti përfshijë ata rregullisht në procesin vendimmarrës."

Lavdie Zhuri Sineballaj



"Poor communities are enriched by engaged citizens exercising their rights and responsibilities," says Lavdie Zhuri, principal of Sineballaj elementary school in Kavaje. She is one of the first citizens that frequently attended the Civic Forum program for two years. "By discussing with each other," she says, "I became more tolerant, more communicative and constructive. In Civic Forum I received knowledge on the democratic principles and community organizing. What's more important, I was convinced that the most valuable asset citizens have in a democracy is the vote."

"We gave our vote to the mayor," says Lavdie, "but, is he going to keep the promises he made to us? Will he bring us the water? If he doesn't, what will we do?" Rather than wait passively to see what time revealed, the group organized a meeting of the community, each family sending at least one representative. After some discussion, the participants of the meeting selected eight people, including Lavdie, to represent the community to the local council to address the issue of water supply. The clear and determined message of the community made the local council approve it. The funds were provided and the Sineballa community secured the water supply.

In September 2003, the Sineballaj citizen group, in which she participates, organized a public discussion between candidates for local elections from the Democratic and Socialist parties. The candidates presented their views and visions to the citizens. In turn, citizens asked questions and were better informed as to the two alternatives.

The Sineballaj community is really poor but the citizens group is now working to enrich it. In June 2004, the group, implementing knowledge gained in Civic Forum, designed a project for rehabilitating the irrigation canal that covers 130ha of land. The total cost of the project was \$13,000 of which \$3,000 were provided by the community itself. Of course this was a big success and it inspired the citizens to further engage in developing their community.

"We must and will increase the number of well-informed citizens so that our voice becomes stronger. This is my priority until the end of the 2005 elections," says Lavdie.

"Ne duhet të rrisim numrin e qytetarëve të mirë-informuar në mënyrë që zëri ynë të dëgjohet më fortë."

"Komunitetet e varfëra i bëjnë të pasur qytetarët e angazhuar duke ushtruar të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre," thotë Lavdie Zhuri, drejtore e shkollës 8-vjeçare në Sineballaj, Kavaje. Ajo është një nga qytetarët e para që ka ndjekur rregullisht prej dy vjetësh programin e Forumit Civil. "Duke diskutuar me njëri tjetrin," thotë ajo, "unë u bëra më tolerante, më komunikuese dhe konstruktive. Në Forumin Civil unë mora njohuri për parimet demokratike dhe organizimin e komunitetit. Çështë me e rëndësishmja, unë u binda se pasuria më e madhe që kanë qytetarët në demokraci është vota."

"Ne ia dhamë votën tonë kryetarit të komunës," thotë Lavdija, "por, a do ta mbajë ai premtimin e dhënë? A do të na e sjellë ujin? Nëse nuk e mban, ç'do të bëjmë ne?" Më mirë se sa të prisim duar-kryq se çfarë do të na sillte koha, grupi organizoi një takim të komunitetit ku çdo familje dërgoi të paktën një përfaqësues. Pas diskutimeve, pjesëmarrësit në takim përzgjedhën tetë vetë, duke përfshirë Lavdien, për të përfaqësuar komunitetin në këshillin vendor në lidhje me çështjen e ujit të pijshëm. Mesazhi i qartë dhe i vendosur i komunitetit e bëri këshillin vendor ta aprovonte këtë çështje. Fondet u gjetën dhe komuniteti i Sineballajt siguroi furnizimin me ujë të pijshëm.

Në Shtator 2003, grupi qytetar i Sineballajt, në të cilin Lavdija merr pjesë, organizoi një diskutim publik mes kandidatëve të zgjedhjeve vendore nga partitë Demokratike dhe Socialiste. Kandidatët paraqitën mendimet dhe vizionet e tyre para qytetarëve. Dhe po kështu, qytetarët bënë pyetje dhe u informuan më mire për të dyja alternativat.

Komuniteti i Sineballajt është vërtetë i varfër por grupi i qytetarëve tani po punon për ta bërë atë të pasur. Në Qershor 2004, grupi, duke zbatuar njohuritë e marra në Forumin Civil, hartoi një projekt për të rehabilituar kanalin vaditës që mbulon 130ha tokë bujqësore. Kostoja totale e këtij projekti ishte \$13 000 nga të cilat \$3 000 u siguruan nga vetë komuniteti. Sigurisht ky ishte një sukses i madh dhe i frymëzoi qytetarët për tu angazhuar edhe më tej në zhvillimin e komunitetit të tyre.

"Ne duhet të rrisim numrin e qytetarëve të mirë-informuar në mënyrë që zëri ynë të dëgjohet më fortë. Ky është prioriteti im deri në fund të zgjedhjeve të 2005-ës," thote Lavdie.

Pasurimi i komuniteteve të varfëra